



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.505/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bajram Kadriu, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Skenderajt, nga radhët e subjektit politik AKR, me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e Bajram Kadriu, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Skenderajt, nga radhët e subjektit politik AKR, me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, me shenjen ZL.Anr.505/2017 të datës 24.10.2017, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017,

A r s y e t i m

Më datën 24.10.2017, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Bajram Kadriu, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Skenderajt, nga radhët e subjektit politik AKR, me të cilën pretendon se ka pasur vjedhje të votave në këto Qendra të Votimit, në Komunën e Skenderajt, si në: shkollën “Hamëz Jashari” 2101x, Ticë 2118b, Kopiliq i Poshtëm 2124b, Terrnac 2127b, Qubrel 2102b, Kllodernicë 2112b, Obri e Ulët 2121b, Prekaz i Ulët 2130b, Vojnik 2110b dhe Leqinë 2112b.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesat e parashtuara përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesa, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, është marrë vendimi përfundimtar, mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ti hudh si të parakohshme ankesat e ankuesit. Hudhja e ankesave të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit i

mohohet e drejta që mbi këtë bazë, që të paraqes ankesë tjetër, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.505/2017 më datën 25.10.2017.



Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Gyltene Sylejmani", written over the printed name.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*